

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega-kryetar, Biljana Rexhiq dhe Mejreme Zekaj - anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Rami Qaka nga f. Bob, komuna Kaçanik nëpërmjet avokatit Selim Idrizi, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik-divizioni për Kundërvajtje, R.I.Nr.2121/12 të datës 28.10.2013, e në bazë të nenit 33, 39, 198, dhe 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datë 29.11.2013, merr këtë

## A K T V E N D I M

Me rastin e ankesës së të pandehurit e sipas detyrës zyrtare, NDYSHOHET aktvendimi i ankimuar, ashtu që ndaj të pandehurit Rami Qaka, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse për shkak të parashkrimit relativ të veprës kundërvajtëse, në vështrim të nenit 198 par.1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet. Shuma e paushallit gjyqësor prej 5.-€, bie në barrë të Gjykatës. Nga një kopje të aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik-divizioni për kundërvajtje, sipas aktvendimit R.I.Nr.2121/12 të datës 28.10.2013, të pandehurin Rami Qaka, e ka shpallë përgjegjës sepse si zyrtar i lartë publik në pozitën e këshilltarit komunal në Asamblenë Komunale në Kaçanik, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë pranë Agjencisë kundër korrupsionit deri më datën 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8. 1.1, të sanksionuar me nenin 17 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, dhe në vështrim të nenit 9 të LK. i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300.-€.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë për shkak të:  
-shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, dhe  
-vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

Në ankesë përpos tjerash thekson se aktvendimi është i pa drejtë, se nuk i është ofruar asnjë formular për nënshkrim për deri sa njoftimi me gojë dhe me email nuk mund të jetë i rregullt, se nuk ka pas për qëllim mshefjen e pasurisë, se me vonesë e bërë deklarin dhe Agjencia nuk është dashtë të ushtroj Kërkesë për fillim të procedurës kundërvajtëse ndaj tij, se mosdeklarimi me kohë nuk ka prodhuar pasoja, etj. dhe propozon që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që ndaj tij të pezullohet procedura kundërvajtëse.

Kolegji i kësaj gjykate, duke e vlerësuar ankesën e paraqitur, aktvendimin e ankimuar dhe shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është jo lëndore.

Nga provat e deponuara dhe të administruara, ankesa e paraqitur si dhe nga shkresat tjera të lëndës, dhe sipas detyrës zyrtare, kolegji i kësaj gjykate konstatoi se për veprën e kryer kundërvajtëse, në rastin konkret ka ardhur deri te parashkrimi relativ i ndjekjes, pasi që vepra kundërvajtëse është kryer më datë 31.03.2012, kurse aktvendimi mbi denimin është marrë më dt.28.10.2013. Sipas nen.27.par.1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, procedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon një vit nga data kur është kryer kundërvajtja, kurse në nen.27 par.3 të LK theksohet se parashkrimi ndërprehet me çdo veprim të organit kompetent që

REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA ANTË KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		PH-SHTINE	
Dep.	DPK/OMP	Nr Prot.	03-4394/13
Dep.		Prot.No	
Nr. i Dos.		Em.	
Proj. Stranica	02	Du. im	23.12.2013
Nr. pages		Data	

2.

ndërmirret për ndjekjen e kryesit të kundërvajtjes,dhe par.4 thekson se me çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedh përsëri.

Sipas kësaj dispozite ky afat duhet të kaloj nga veprimi i fundit procedural e që nga shkresat e lëndës del se veprimi i fundit preoedural ka qenë procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit më dt.27.08.2012, ashtu që nga data e cekur më lartë e gjer më datën e marrjes në pyetje të dëshmitarit dhe marrjes së Aktvendimit- më 28.10.2013, ka kaluar më shumë se një vit,andaj konform të nenit 27 al. 1 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, pezullohet procedura kundërvajtëse dhe i pandehuri Rami Qaka lirohet nga përgjegjësia kundërvajtëse.

Më sa u tha më lartë konform të nenit 219 dhe 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankese.  
GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË.  
KA.nr.1252/2013 të datës 29.11.2013.

Bashk.profesionale,  
Sebahate Hoti

